



Tiranë, më 19.02.2026, nr.324 prot.



Tiranë, më 23.02.2026, nr.486 prot.

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH)
DHE
UNIVERSITETI "ALEKSANDER MOISIU" DURRËS**

**Neni 1
Përcaktimi i Palëve**

Palët në këtë Marrëveshje janë:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me qendër në Tiranë, Shëtitorja Murat Toptani, Tiranë 1000, i përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar;
2. Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD), me adresë: L. Nr.1, Rruga "Taulantia" Durrës, Shqipëri, i përfaqësuar nga prof. dr. Shkëlqim Fortuzi, Rektori.

**Neni 2
Qëllimi**

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndërinstitucional midis *Palëve*, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre; përcaktimin e prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithë pranuar dhe në interesa të përbashkëta.

**Neni 3
Parime bazë**

Parim themelor rregullues për bashkëpunimin e *Palëve* është *liria akademike dhe autonomia universitare*. Palët bashkëpunojnë duke respektuar njëra-tjetrën në vetëveprimin e tyre të

rregulluar me ligje dhe me akte nënligjore, duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme, përmes nismash, projektesh dhe veprimtarish të përbashkëta akademike e kërkimore-shkencore. Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre Palët pranojnë dhe respektojnë Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagjiaturës dhe pseudoshkencës.

Neni 4

Drejtimit kryesore të bashkëpunimit

Bashkëpunimi midis *Palëve* shtrihet në gjithë fushat e dijes. Palët bashkëpunojnë me përparësi në shkencat albanologjike: gjuhësi, arkeologji, histori, antropologji kulturore, trashëgimi shpirtërore e identitare, studime letrare e kulturore, shkenca sociale, juridike dhe ekonomike, gjeografi, si dhe në disiplina të shkencave natyrore e teknike: nanoshkencë; bioshkencë; matematikë-fizikë; dhe shkenca të jetës; duke përfshirë disiplina të qm kanë lidhje me fusha prioritare, si tërmetet, imunologji, gjenetikë, nanoteknologji, bioteknologji, ambienti dhe studimet mbi ujërat.

Palët bashkëpunojnë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si: kuvende, kongrese, konferenca, forume, simpoziume etj.

Palët bashkëpunojnë për kryerjen e studimeve të përbashkëta.

Palët bashkëpunojnë për aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore vendore, rajonale dhe europiane.

Palët bashkëpunojnë për nxitjen dhe promovimin e studiuesve të rinj.

Palët bashkëpunojnë për hartimin e strategjive të zhvillimit dhe të akteve normative në zbatim të tyre.

Palët bashkëpunojnë për programe të veçanta akademike afatshkurtra;

Palët bashkëpunojnë për organizim të shkollave verore/dimërore;

Palët bashkëpunojnë për aktivitete në ndërtimin e kapaciteteve;

Palët bashkëpunojnë për krijimi i një rrjeti për shkëmbime të përvojës në tematika të ndryshme.

Palët angazhohen të vendosin në dispozicion të bashkëpunimit për zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore infrastrukturën e tyre.

Neni 5

Bashkëpunime të veçanta

Njësitë bazë dhe Senati i Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës marrin pjesë në procesin e promovimit të kandidatëve për anëtarë të Asamblesë së ASHSH, në zgjerim të traditave të mirënjohura të bashkëpunimit, siç parashikohet në Ligjin dhe në Statutin e saj.

Përfaqësues të trupës akademike të UAMD përfshihen sipas fushave në *komisionet e përhershme* që funksionojnë pranë ASHSH.

ASHSH inkurajon përfshirjen e ekspertëve të UAMD në *njësitë e reja të kërkimit shkencor* ngritur pranë saj, UAMD rekomandon e propozon përfshirjen e ekspertëve më cilësorë, palët bashkëpunojnë në realizimin e veprimtarisë së tyre.

ASHSH fton përfaqësues të UAMD të marrin pjesë si anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues dhe oponentë në organizimin dhe zhvillimin e konkurseve shkencore për *çmimet kombëtare vjetore* të shpallura prej saj, në të gjitha fazat e tyre.

Përfaqësues të UAMD marrin pjesë në organizma të ASHSH ose që funksionojnë pranë saj, si *këshilli i botimeve akademike* etj.

ASHSH dhe UAMD ofrohen për bashkëpunim për hartimin e programeve të veçanta të studimeve universitare për shkallët *master* dhe *doktoratë*, si dhe për drejtimin shkencor të tyre.

ASHSH mundëson zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve të UAMD pranë saj dhe njësive kërkimore të saj.

Neni 6

Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

Palët i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive. ASHSH u dhuron periodikisht koleksione të botimeve të saj bibliotekave të UAMD.

Palët shkëmbejnë ekspertiza dhe mbikëqyrje të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime.

Neni 7

Zbatimi dhe kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje ka fuqi veprimi me kohë të papërcaktuar.

Palët takohen sa here që e gjykojnë të nevojshme të mbledhen për të vlerësuar ecurinë e Marrëveshjes.

Ndërprerja e saj pranohet prej *Palëve* në rastet kur:

- Ndryshon *statusi ligjor i institucioneve* dhe ky ndryshim *prek funksionet themelore* të tyre, me efekt në *Palën* tjetër;
- Njëra nga *Palët* shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Protokollet e bashkëpunimit

Me vullnetin e *Palëve* kësaj Marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokolle mund të nënshkruhen dhe për një veprimtari apo projekt të vetëm.

Pikë kontakti për ASHSH do të jetë znj. Alma Bela, Specialiste e burimeve njerezore dhe juriste

në adresën elektronike: alma.bela@akad.gov.al dhe për UAMD pikë kontakti do të jetë znj. Denisela Beqaj, Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorja e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në adresën elektronike: deniselabeqaj@uamd.edu.al , www.uamd.edu.al.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo Marrëveshje është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme *Palët* nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Mosmarrëveshjet midis *Palëve* zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë me bisedime për një periudhë dyvjeçare për çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.

Neni 10

Të fundme

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe, një për secilën *Palë*, me vlerë të barabartë. Marrëveshja bëhet e vlefshme menjëherë pas nënshkrimit nga titullarët përkatës.

Për:

Akademinë e Shkencave të Shqipërisë	Universitetin Aleksander Moisiu Durrës
Kryetari Akad. Skënder Gjinushi 	Raktori Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi 

ANEKS Nr. 1

PËR PJESËMARRJE SI PARTNER NË PROJEKT KËRKIMOR-SHKENCOR

“Përcaktimi i aftësive mbajtëse të ngarkesës turistike në peizazhet natyrore e sociale, përmes sigurimit/përpunimit të informacionit me teknologji të avancuara GIS e Drone dhe digitalizimit me metoda të reja: Model ndërdisiplinor Ksamil–Butrint.”

Në kuadër të thirrjes së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me këtë aneks deklarojmë se:

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, me seli në Durrës, përfaqësuar nga prof. dr. Shkëlqim Fortuzi, në cilësinë e Rektorit shpreh vullnetin dhe angazhimin institucional për të marrë pjesë si partner me konceptidenë e sipërcituar që do të aplikohet pranë AKKSHI nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si institucion koordinator / aplikues (Prof. Dr. Perikli Qirjazi, Drejtues i Njësisë së Kërkimeve Gjeografike).

Palët angazhohen të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë në zbatimin e projektit, në rast se projekti shpallet fitues dhe financohet nga AKKSHI, përmes:

- pjesëmarrjes së stafit akademik dhe kërkimor në aktivitetet shkencore të projektit;
- realizimit të detyrave dhe aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës;
- bashkëpunimit në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave kërkimore;
- përgatitjes së raporteve teknike dhe shkencore sipas kërkesave të AKKSHI;
- përhapja e rezultateve përmes publikimeve, konferencave dhe aktiviteteve të tjera shkencore.

Ky angazhim bazohet në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, dhe ka për qëllim garantimin e bashkëpunimit institucional gjatë gjithë ciklit të projektit.

Ky aneks lëshohet për t’u përdorur si dokument shoqërues në dosjen e aplikimit të projektit pranë AKKSHI.

Aneksi nr. 1 është pjesë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr ___, datë _____ 2026 ndërmjet ASHSH dhe UAMD


PËR

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Kryetari

Akad. Skënder GJINUSHI

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Rektori

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

